

URDHËR
Nr. 360/2, datë 3.8.2016

PËR DELEGIM KOMPETENCASH PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT PUBLIK

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, në nenet 22 e vijues, të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së titullarit të Autoritetit Kontraktor, Ministria e Punëve të Jashtme, drejtorit të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Shërbimeve të Brendshme, znj. Etleva Haka, për nënshkrimin e akteve të procedurave të prokurimit, vlera e të cilave, brenda një viti kalendarik, është më e vogël se 800,000 (tetëqind mijë) lekë.

2. Këto kompetenca do të ushtrohen nga data e daljes së këtij urdhri.

3. Drejtori i DÇJSHB-së nuk mund të nëndelegojë këto kompetenca.

4. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit, si dhe pushimin e ekzistencës së organit delegues apo të deleguar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË JASHTME
Ditmir Bushati